



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Teknologji Ushqimore me Bioteknologji (TUBT)

Programi: SHKENCA E USHQIMIT

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Bsc. Riad Qerimi, me titull:

“Vlerësimi fiziko-kimik dhe mikrobiologjik i ujit të pijshëm të prodhuar nga prodhuesit vendor”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 07.12.2023 deri me datë 14.12.2023.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. *Prof. Alltane Kryeziu*, kryetare,
2. *Prof. Xhavit Ramadani*, anëtar/mentor,
3. *Prof. Muhamet Kamberi*, anëtar.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës *Prof. Asoc. Dr. Xhavit Ramadani*, përmes e-mail adresës xhavit.ramaadani@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë!

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: TEKNOLOGJI USHQIMORE ME BIOTEKNOLOGJI
PROGRAMI: SHKENCA E USHQIMIT



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

**Vlerësimi fiziko-kimik dhe mikrobiologjik i ujit të pijshëm
të prodhuar nga prodhuesit vendor**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Xhavit Ramadani

Kandidati:

Bsc. Riad Qerimi

Prishtinë, Dhjetor 2023

PËRMBLEDHJA

Uji është një përbërës që është i përfshirë drejtpërdrejt në shumë procese fiziologjike të të gjithë organizmat e gjallë. Organizmi i njeriut në 60-75% të peshës së trupit përmban ujë dhe ujin e përdorë për funksionimin e të gjitha qelizave, indeve dhe organeve, për të ndihmuar në rregullimin e temperaturës së trupit dhe ruajtjen e funksioneve të tjera trupore. Si rezultat i furnizimit me ujë të pasigurt si dhe mungesës së higjienës, rreth 90% e sëmundjeve rrjedhin nga uji, me ç'rast preken kryesisht fëmijët në vendet e pa zhvilluara dhe ato në zhvillim. Objektivi kryesor i këtij hulumtimi ka qenë vlerësimi dhe krahasimi përbërjes fiziko-kimike dhe cilësisë mikrobiologjike të ujit të burimit (ujësjellësit) në Prishtinë dhe ujit të ambalazhuar të prodhuar në Kosovë. Për të realizuar qëllimin e hulumtimit, mostrat e ujit janë marrë në pikat e përdorimit të ujit në amvisëritë që furnizohen nga uji i burimit (ujësjellësit) tek disa familje në disa lagje të Prishtinës si dhe nga tetë prodhues vendor të ujit të ambalazhuar. Gjithsej janë analizuar 300 mostra të ujit. Bazuar në rezultatet e analizave fiziko-kimike të ujit të burimit është konstatuar kjo përmbajtje: bikarbonatet 190.81 mg/l, kalciumi 38.97 mg/l, magnezi 10.77 mg/l, kloruret 90.61 mg/l, nitritet 0.005 mg/l, nitratet 0.44 mg/l, sulfatet 13.00 mg/l, sulfitet 0.06 mg/l. Vlerat e nitriteve kanë qenë mbi standardin e lejuar. Vlerat mesatare të vetive fizike të ujit të burimit kanë qenë: fortësia totale 7.93 °D, pH 7.72, përqeshmëria elektrike 327.36 $\mu\text{S}/\text{cm}^3$. Uji i ambalazhuar ka treguar këtë përmbajtje mesatare kimike: bikarbonatet 172.78 mg/l, kalciumi 28.56 mg/l, magnezi 7.54, kloruret 39.80 mg/l, nitritet 0.01 mg/l, nitratet 0.39 mg/l, sulfatet 7.90 mg/l, sulfitet 0.06 mg/l. Nivelet e nitriteve kanë qenë mbi standardin e lejuar në të gjitha kompanitë Edhe te ky lloj i ujit, nivelet e nitriteve kanë qenë mbi standardin e lejuar në të gjitha kompanitë. Vlerat mesatare të vetive fizike të ujit të ambalazhuar kanë qenë: fortësia totale 5.73 °D, pH 7.49, përqeshmëria elektrike 289.40 $\mu\text{S}/\text{cm}^3$. Tek cilësia mikrobiologjike e ujit të burimit, vlerat mesatare kanë qenë: koliformet totale 0.80 cfu gr/ml, klostridiet 0.0 cfu gr/ml, streptokoket fekale 0.48 cfu gr/ml. Tek uji i ambalazhuar vlerat mesatare kanë qenë 0.10 cfu gr/ml për koliformet totale, 0.0 cfu gr/ml për klostridiet dhe streptokoket fekale. Rezultatet sugjerojnë se cilësia mikrobiologjike e ujit të burimit në pikat e amvisërisë ka disa probleme, për shkak të numrit të bakterieve koliforme totale dhe streptokokeve fekale mbi nivelin e lejuar. Këto probleme mund të ndikojnë në sigurinë e ujit dhe duhet të monitorohen dhe adresohen për të siguruar ujë të sigurtë për konsumin njerëzor, ndërsa tek uji i ambalazhuar nuk janë gjetur bakterie klostridie dhe streptokoke fekale por që niveli mesatar i koliformeve totale ka qenë mbi nivelin e lejuar. Kjo tregon se uji i ambalazhuar ka pasur probleme me kontaminimin mikrobiologjik.

Në kuadër të përbërjes kimike, vetive fizike, si dhe cilësisë mikrobiologjike mes ujit të burimit dhe atij të ambalazhuar, nuk janë regjistruar dallimet statistike të rëndësishme në nivelin $P < 0.001$ në asnjërin nga treguesit e analizuar.

Fjalët kyçe: Cilësia e ujit, uji i burimit, uji ambalazhuar